



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE, STREHIMIT DHE KOORDINIMIT ME
NJA-të
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Nr. 1316/ Prot

Gramsh më, 11.03 2024

VENDIM

Nr. 23 dt. 28 /03/2024

PËR

“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e shtetasit Dallim Mema, fshati Irmath, Njësia Administrative Kukur, bashkia Gramsh, si dhe dëmshpërblimin financiar të kësaj familje”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 28.03.2024, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimit dhe Koordinimit me NJA-të, sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e shtetasit **Dallim Mema**, banorë në fshatin Irmath, bashkia Gramsh, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për dëmet ndërtimore si dhe ato në pajisje e orendi të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 të përlogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë, për shtetasin **Dallim Mema** në vlerën **305 295** (treqind e pesë mijë e qyqind e nëntëdhjetë e pesë)lekë.

3. Ti akordoj familjes së shtetasit Dallim Mema , ndihmën emergjente në vlerën prej **305 295 (treqind e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë)** lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2024.
4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Dallim Mema, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Dallim Mema , banesa e të cilëve është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimit dhe Koordinimit me NJA-të (Sektori i Emergjencave Civile), si dhe Drejtoria Financës dhe Buxhetit.


Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ENIS ZANI



sek. Këshillit
Drejtoria Publike dhe Em. Civile



26.04.2024

REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 496/ Prot.

Elbasan më 25.4.2024

Lënda: Mbi ligjshmërinë

KËSHILLIT TË BASHKISË GRAMSH

Adresa: Bashkia Gramsh, Blv 10 Korriku, Sheshi Kamber Dyrmyshi,

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit tuaj Nr.29 datë 28.03.2024 "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e shtetasit Dallim Mema, banor në fshatin Irmath, Njësia Administrative Kukur, bashkia Gramsh (në shumën 305,295 lekë)", para se të shprehemi mbi ligjshmërinë e aktit tuaj kërkojmë të na dërgoni dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor të parashikuar në V.K.M Nr 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi në dosjen e vendimit tuaj mungojnë këto dokumenta:

- a-Kërkesa me shkrim e qytetarit;
- b-Certifikata familjare në momentin e ndodhjes së ngjarjes;
- c-Urdhri i kryetarit të bashkisë;
- d-Akt- ekspertiza nga MZSH;

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale (me vulë të njomë) ose të njehsuara me origjinalin, pasi edhe dokumentat që janë në dosjen tuaj përveç vendimit janë fotokopje. Deri në dërgimin e plotë të dokumentacionit, akti i juaj mbetet i pakonfirmuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

